



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:079571
Datë: 10.10.2024
Numri i dokumentit: 06278324

Ac.nr.6068/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Nora Bllaca-Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.B nga fshati B....., Komuna e M....., të cilin me autorizim e përfaqëson Av. N.K nga Malisheva kundër të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike, kompensim i pagave jubilarë dhe kompensim i shujtave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.85/2022, të datës 24.07.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 07.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.85/2022, i datës 24.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.85/2022, i datës 24.07.2023, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.B nga fshati B....., Komuna e M..... II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës — Drejtoria e Arsimit paditëses V.B nga fshati B....., Komuna e M..... në emër të shujtës ditore të përlogaritur për periudhën për vitin 2020-2022 për 375 ditë pune, i'ia paguaj nga 2 euro në shumën prej 750.00 euro dhe në emër të një page jubilarë prej 75% në shumën prej 391.23 euro ne shumën e përgjithshme prej 1,141.23 euro, te gjitha me kamate ligjore prej 8% qe nga dita e paraqitjes së padisë dt. 01.03.2021, të gjitha këto ne afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. IV. DETYROHET e paditura që*

paditëses i'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, paditëses dhe atë në emër të parashtrimi të padisë në shumën prej 104.00 euro, në emër të precizimit të padisë shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro në shumën e përgjithshme prej 229.00 euro”.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar ashtu që lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesën ka parashtruar pala paditëse përmes përfaqësuesit të saj Nuhi Krasniqi, avokat nga Malisheva me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzoj ankesën e të paditurës dhe ta vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë ka parashtruar padinë ndaj të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria e Arsimit sipas bazës juridike kompensim i pagave jubilarë dhe shujtave ditore. Sipas padisë paditësi për më shumë se 21 vite punon mësimdhënës në SHFMU "T....." në fshatin B....., meqenëse ka mbi 21 vite të punës, paditësja lakon paga jubilarë prej 75% të pagës baze, po ashtu paditësi kërkon nga e paditura kompensimin e shujtës dhe me datën 27.01.2023 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke theksuar se në emër të shujtave ditore e paditura i ka borxh paditëses për vitin 2020, 60 ditë pune, për vitin 2021, 175 ditë pune, për vitin 2022, 140, ditë pune në gjithsejtë 750 euro, dhe në emër të pagës jubilarë shumën prej 391.23 euro, në total 1,141.23 euro si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës në kuptim të nenit 152 të LPK-së, pa shqyrtim kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.85/2022, i datës 24.07.2023, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës mësimdhënës në SHFMU "T....." në fshatin B....., ndërsa kontestues mes palëve ndërëgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin e plotë në emër të kompensimit të pagës jubilarë, dhe kompensimit të shujtave, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 par. 7 në të cilën përcaktohet se "*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë,*

për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim", ndërsa lidhur me pagën jubilarë në paragrafin paragrafi 8 në të cilën përcaktohet se "Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) për vitet jubilarë të punësimit përfitojnë çmimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë dhe atë për 10 vite përvojë të punës në vlerën prej 50% të një page bazë, për 20 vite përvojë të punës në vlerë prej 75% të një page bazë, për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page bazë dhe 40 vite të përvojës së punës në vlerën prej 150% të një page bazë, ndërsa shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve të nenit 8".

Për bazën juridike i është referuar dispozitës së nenit 35 paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, lidhur me kumatën iu referuar nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës iu referua nenit 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale.

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar se paditëses i takon e drejta në vlerën 75 % të një pagë bazë në emër të shpërblimit jubilar në shumën e gjykuar, ngase është vërtetuar se e njëjta është e punësuar tek punëdhënësi mbi 20 vite dhe 20 vite të përvojës së punës i ka përmbushur në vitin 2021 brenda kohës së fuqisë së Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sipas të cilës parashihet se: mbi 20 vite përvojë pune punëmarrësit i takon shpërblimi jubilar në vlerë të 75 % të një page bazë, ndërsa lartësia e pagës së paditëses është vërtetuar nga lista e pagave të realizuara nga paditësja.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpërblim jubilar dhe kompensim për ushqim në ditët e pranisë në punës për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve". Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në

nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt. 18.04.2017, përcaktohet se: *“punëtorët (anëtar të SBASH-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një pagë bazë, për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vite të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë”*. Ndërsa nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimi për një ditë të pranisë në punë është 2 €, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë formë tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin”*. Andaj, për kompensimin e pagës jubilarë drejtë është vendosur shuma prej 391.23 €, si dhe për vlerën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për 375 ditë të punës, me të drejtë iu është njohur shuma prej 750 €, e gjithsej shuma prej 1.141.23 €.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës dhe pagës jubilarë për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të t ‘paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim ushqimit dhe kompensimin e udhëtimit për ditët e pranisë në punë i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëseve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale të referuar për këtë çështje juridike kontestuese, nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, konform nenit 194 të LPK-së si dhe kjo gjykatë i mori parasysh të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6068/2023, me datë 07.10.2024

Kryetar i kolegjit - Gjyqtari
Qerim Ademaj, d.v.